



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRANAK LIPLJAN

P.nr.191/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Elvira Emimi, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. Ll. nga fsh. D. e M. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.6856/2016 të dt.07.03.2017, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 pika 1.4 KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-Prishtinë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë seancës gjyqësore me dt. **10.03.2017** merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP.II.nr.6856/2016 të dt.07.03.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit:

A. Ll., nga i ati G., dhe e ëma Xh., e gjinisë S., i lindur me dt. *data e lindjes...* në P., me vendbanim në fsh. D. e M. K. L., me nr. personal *numër personal...*, shqipëtar shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I pandehuri A. Ll. me datë 30.10.2016, në fushën e sportit në fshatin Dobrajë e Madhe të Lipjanit, pasi që kishte përfunduar ndeshja e futbollit, i pakënaqur me ndarjen e drejtësisë me dashje e kishte sulmuar fizikisht ashtu që e kishte goditur me grusht në kokë gjyqtarin tani të dëmtuarin L. B., duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata, konform neneve, 1, 2, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73, 188 të KPRK-së, dhe dispozitat e nenit 493, 495 dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200-€ (dyqind euro)**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konfrom nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

I dëmtuari L. B. nga fsh. S. K. P., udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt gjyqësore.

DETYROHET i akuzuari në emër të shpenzimeve të procedurës penale, kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 20-€, si dhe për paushall gjyqësor shumën prej 20-€, në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj, PP.II.nr.6856/2016 të dt.07.03.2017, e ka akuzuar, të pandehurin, A. Ll., për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe njëkohësisht ka kërkuar që ndaj të njëjtit të shqiptohet urdhri ndëshkimor-dënimi me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal të dt. 30.11.2016, Mendimi i ekspertit mjeko-ligjor të dr. N. U. i dt. 26.12.2016, dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj kjo gjykatë të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqyrtojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 1 (një) vit, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. 2 nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore- juridike, të dëmtuarës u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN

P.nr.191/17, me dt.10.03.2017

Bashkëpunëtorja profesionale

Elvira Emini

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e dorëzimit së të njëjtit. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate.